

32001L0029

Direktiva 2001/29/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit e 22 majit 2001, mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, në shoqërinë e informacionit.

Gazeta Zyrtare L 167, 22/06/2001 fq. 0010 – 0019.

Direktiva 2001/29/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit e 22 majit 2001, mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, në shoqërinë e informacionit.

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European, dhe në veçanti nenet 47 pika 2, 55 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 251 të Traktatit [3],

Duke pasur parasysh se:

- (1) Traktati parashikon themelimin e tregut të brendshëm dhe vendosjen e një sistemi që siguron që konkurrenca në tregun e brendshëm të mos çekuilibrohet. Harmonizimi i ligjeve të Shteteve Anëtare për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me to kontribuon në arritjen e këtyre objektivave.
- (2) Këshilli European, në takimin e Korfuzit më 24 dhe 25 qershor 1994, theksoi nevojën për të krijuar një kuadër ligjor të përgjithshëm dhe fleksibël në nivel Komuniteti në mënyrë që të nxitet zhvillimi i shoqërisë së informacionit në Europë. Kjo kërkon, *inter alia*, praninë e një tregu të brendshëm për produkte dhe shërbime të reja. Ka filluar tashmë hartimi i legjislacionit të rëndësishëm Komunitar për të siguruar se një kuadër rregullator i tillë është në punë. E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë kuptim sepse mbrojnë dhe nxitin zhvillimin dhe reklamimin e produkteve dhe shërbimeve të reja dhe krijimin dhe shfrytëzimin e përmbajtjeve krijuese të tyre.
- (3) Harmonizimi i propozuar ndihmon në zbatimin e katër lirive të tregut të brendshëm dhe lidhet me përputhshmërinë me parimet themelore të ligjit dhe, veçanërisht, të pronësisë, duke përfshirë pronësinë intelektuale dhe lirinë e të shprehurit dhe interesin publik.
- (4) Një kuadër ligjor i harmonizuar për të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të, nëpërmjet një sigurie ligjore në rritje dhe duke parashikuar njëkohësisht një shkallë të lartë mbrojtjeje të pronësisë intelektuale, nxit investime të mëdha në krijimtari dhe risi, duke përfshirë infrastrukturë të rrjetëzuar dhe, për rrjedhojë, çon në zhvillim dhe konkurrueshmëri më të madhe të industrisë Europiane, si në fushën e sigurimit të përmbajtjes dhe teknologjisë së informacionit dhe më në përgjithësi në një shtrirje më të gjerë të sektorëve industriale dhe kulturore. Kjo mbron punësimin dhe nxit krijimin e vendeve të reja të punës.
- (5) Zhvillimi teknologjik ka shumëfishuar dhe bërë më të larmishme mundësitë për krijim, prodhim dhe shfrytëzim. Ndërkohë që nuk ka nevojë për koncepte të reja në mbrojtjen e pronësisë intelektuale, ligji në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhur me të duhet të përshtatet dhe të mbështetet që t'i përgjigjet në mënyrë të duhur realitetit ekonomik siç janë forma të ndryshme shfrytëzimi.

(6) Pa harmonizim në nivel Komunitar, aktivitetet legjislativë në nivel kombëtar, të cilat kanë filluar tashmë në disa Shtete Anëtare për t'iu përgjigjur sfidave teknologjike mund të çojnë në dallime të mëdha në mbrojtje dhe, rrjedhimisht, në kufizime të lëvizjes së lirë të shërbimeve dhe produkteve që përfshijnë, ose bazohen në, pronësinë intelektuale, duke çuar në një ricopëzim të tregut të brendshëm dhe parregullsi legjislativë. Ndikimi i dallimeve dhe pasigurive të tilla mund të bëhet më i theksuar me zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë së informacionit, e cila tashmë ka rritur ndjeshëm shfrytëzimin tejkuftar të pronësisë intelektuale. Ky zhvillim duhet të rritet më tej. Dallimet dhe pasiguritë e ndjeshme legjislativë të mbrojtjes mund të pengojë ekonominë e shkallës për produkte dhe shërbime të reja që zotërojnë të drejta autori dhe të drejta të lidhura me to.

(7) Prandaj, kuadri ligjor i Komunitetit për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të duhet gjithashtu të përshtatet dhe mbështetet aq sa të jetë e nevojshme që tregu i brendshëm të funksionojë normalisht. Për këtë qëllim, dispozitat kombëtare për të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të që dallojnë ndjeshëm nga një Shtet Anëtar të një tjetër ose që shkaktojnë pasiguri ligjore që pengojnë funksionimin normal të tregut të brendshëm dhe zhvillimin e duhur të shoqërisë së informacionit në Europë duhet të përshtaten dhe përgjigje të çrregullta kombëtare të zhvillimeve teknologjike duhet të shmangen, ndërsa dallimet që nuk ndikojnë ndjeshëm në funksionimin e tregut të brendshëm nuk është e nevojshme të hiqen ose të ndalohen.

(8) Pasojat e ndryshme sociale, komunitare dhe kulturore të shoqërisë së informacionit kërkojnë që tiparet e veçanta të përmbajtjes së produkteve dhe shërbimeve të merren parasysh.

(9) Çdo harmonizim i të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të duhet të ketë për bazë një nivel të lartë mbrojtjeje meqenëse të drejta të tilla janë vendimtare për krijimin intelektual. Mbrojtja e tyre ndihmon që të sigurohet mirëmbajtja dhe zhvillimi i krijimtarisë në dobi të autorëve, aktorëve, producentëve, kulturës, industrisë dhe publikut të gjerë. Prandaj, pronësia intelektuale njihet si një pjesë thelbësore e pronësisë.

(10) Nëse autorët ose aktorët vazhdojnë punën e tyre artistike dhe krijuese, ata duhet të marrin shpërblim të përshtatshëm për përdorimin e veprës së tyre, ashtu si dhe producentët në mënyrë që të financojnë këtë punë. Investimi i kërkuar për të prodhuar produkte si fonograme, filma ose produkte multimediale dhe shërbime si ato "me kërkesë" është i madh. Një mbrojtje ligjore e përshtatshme e të drejtave të pronësisë intelektuale është e nevojshme në mënyrë që të garantohet disponueshmëria e një shpërblimi të tillë dhe të jepet mundësia e një kthimi të kënaqshëm të këtij investimi.

(11) Një sistem i efektshëm dhe rigoroz për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të është mënyra kryesore për të siguruar që prodhimi dhe krijimtaria kulturore Europiane marrin burimet e nevojshme dhe për të mbrojtur lirinë dhe dinjitetin e krijuesve dhe aktorëve artistikë.

(12) Një mbrojtje e përshtatshme e veprave me të drejtë autori dhe tema e të drejtave të lidhura me të është gjithashtu e një rëndësie të madhe nga një këndvështrim kulturor. Neni 151 i Traktatit kërkon që Komuniteti të marrë parasysh pikëpamjet kulturore në veprimet e tij.

(13) Një kërkim i përbashkët dhe zbatim i vazhdueshëm në nivel European i masave teknike për të mbrojtur veprat dhe tema të tjera dhe për të dhënë informacionin e nevojshëm për të drejtat janë thelbësore për kohë që qëllimi përfundimtar i këtyre masave është t'i japë fuqi parimeve dhe garancive të përcaktuara në ligj.

(14) Kjo direktivë duhet të ketë për qëllim të nxitë mësimin dhe kulturën duke mbrojtur vepra dhe tema të tjera ndërkohë që lejon përjashtime ose kufizime në dobi të publikut për qëllim formimi dhe mësimdhënieje.

(15) Konferenca Diplomatike e zhvilluar me mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI) në dhjetor 1996 çoi në miratimin e dy Traktateve të reja, “Traktati i OBPI-së për të Drejtën e Autorit” dhe “Traktati i OBPI-së për Shfaqjet dhe Fonogramet”, që merren përkatësisht me mbrojtjen e autorëve dhe mbrojtjen e aktorëve dhe producentëve të fonogrameve. Këto Traktate përditësojnë mbrojtjen ndërkombëtare për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të në mënyrë të theksuar, as më pak në lidhje me të ashtuquajturën “programi dixhital”, dhe përmirësojnë mjetet për luftën kundër piraterisë në mbarë botën. Komuniteti dhe shumica e Shteteve Anëtare i kanë nënshkruar tashmë Traktatet dhe po zhvillohet procesi i planifikimit të rregullimeve për ratifikimin e Traktateve nga Komuniteti dhe Shtetet Anëtare. Kjo direktivë shërben gjithashtu për zbatimin e një sërë detyrimeve ndërkombëtare të reja.

(16) Përgjegjësia për aktivitetet në rrjet lidhet jo vetëm me të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të, por edhe fusha të tjera, si shpifjet, reklama keqinformuese ose shkelja e shenjës dalluese të regjistruar dhe adresohet në të njëjtën mënyrë në Direktivën 2000/31/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 8 qershor 2000, për disa pikëpamje ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, në veçanti tregtinë elektronike, në tregun e brendshëm (“Direktiva për tregtinë elektronike”) [4], e cila sqaron dhe harmonizon çështje ligjore të ndryshme në lidhje me shërbimet e shoqërisë së informacionit duke përfshirë tregtinë elektronike. Kjo direktivë duhet të zbatohet brenda një afati kohor të ngjashëm me atë për zbatimin e Direktivës për tregtinë elektronike, meqenëse ajo direktivë jep një kuadër parimesh të harmonizuara dhe dispozita të lidhura, *inter alia*, me pjesë të rëndësishme të kësaj direktive. Kjo direktivë nuk cenon dispozitat e lidhura me përgjegjësinë në atë direktivë.

(17) Është e nevojshme, veçanërisht duke marrë parasysh kërkesat e lindura nga mjedisi dixhital, të sigurohet që shoqëritë mbledhëse arrijnë një nivel më të lartë arsytimi dhe transparence në lidhje me përputhjen me rregullat e konkurrencës.

(18) Kjo direktivë nuk cenon rregullat e Shteteve Anëtare në lidhje me organizimin e të drejtave si licencat e përbashkëta të zgjatura.

(19) Të drejtat morale të mbajtesve të të drejtave duhet të ushtrohen sipas ligjit të Shteteve Anëtare dhe dispozitave të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, të Traktatit të OBPI-së për të Drejtën e Autorit dhe Traktatit të OBPI-së për Shfaqjet dhe Fonogramet. Të drejta morale të tilla mbeten jashtë fushës së zbatimit të kësaj direktive.

(20) Kjo direktivë bazohet në parimet dhe rregullat e përcaktuara paraprakisht në direktivat tani në fuqi në këtë fushë, në veçanti Direktivat 91/250/KEE [5], 92/100/KEE [6], 93/83/KEE [7], 93/98/KEE [8] dhe 96/9/KE [9], dhe i zhvillon ato parime dhe rregulla dhe i përshtat sipas kuptimit të shoqërisë së informacionit. Dispozitat e kësaj direktive nuk duhet të cenojnë dispozitat e direktivave të mësipërme, përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë direktivë.

(21) Kjo direktivë duhet të përcaktojë fushën e zbatimit të akteve të mbuluara nga e drejta e riprodhimit në lidhje me përfituesit e ndryshëm. Kjo duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin e BE-së. Një përkufizim i gjerë i këtyre akteve është i nevojshëm për të pasur siguri ligjore brenda tregut të brendshëm.

(22) Objektivi i mbështetjes së duhur për shpërndarjen e kulturës nuk duhet të arrihet duke hequr dorë nga mbrojtja e fortë e të drejtave ose duke lejuar mënyra të jashtëligjshme për shpërndarjen e veprave të falsifikuara ose pirate.

(23) Kjo direktivë duhet të harmonizojë më tej të drejtën që autori ka për të komunikuar me publikun. Kjo e drejtë duhet të kuptohet në një kuptim të gjerë dhe që mbulon të gjithë komunikimin me publikun e papranishëm në vendin ku nis komunikimi. Kjo e drejtë duhet të mbulojë çdo transmetim ose ritransmetim të tillë të një veprë

drejtuar publikut me fije ose pa fije, duke përfshirë transmetimet në radio dhe televizion. Kjo e drejtë nuk duhet të mbulojë akte të tjera.

(24) E drejta për të bërë të disponueshme për publikun tema të përmendura në nenin 3 pika 2 duhet të kuptohet e tillë që mbulon të gjithë aktet e bërjes së disponueshme të temave të tilla publikut të papranishëm në vendin ku nis akti i bërjes së disponueshëm dhe pa mbuluar akte të tjera.

(25) Pasiguria ligjore në lidhje me natyrën dhe nivelin e mbrojtjes së akteve të transmetimeve me kërkesë të veprave me të drejta autori dhe tema të mbrojtura nga të drejtat e lidhura me të në rrjete duhet të shmanget duke parashikuar mbrojtje të harmonizuar në nivel Komuniteti. Duhet sqaruar që të gjithë mbajtësit e të drejtave të njohur nga kjo direktivë duhet të gëzojnë të drejtën ekskluzive për t'i bërë të disponueshme publikut vepra me të drejtë autori ose çdo temë tjetër nëpërmjet transmetimeve me kërkesë ndërvepruese. Transmetime të tilla me kërkesë ndërvepruese dallohen nga fakti se publiku mund t'i aksesojë ato nga kudo dhe në kohën e tyre.

(26) Në lidhje me bërjen të disponueshme të shërbimeve me kërkesë nga transmetuesit e prodhimeve të tyre të radios ose televizionit që përfshijnë muzikë nga fonograme tregtare si pjesë kryesore e tyre, duhen nxitur marrëveshje licensuese të përbashkëta në mënyrë që të lehtësohet pranimi i të drejtave në fjalë.

(27) Dhënia e thjeshtë e ambienteve fizike për të mundësuar ose për të bërë një komunikim nuk quhet në vetvete komunikim brenda kuptimit të kësaj direktive.

(28) Mbrojtja e të drejtës së autorit sipas kësaj direktive përfshin të drejtën ekskluzive për të kontrolluar shpërndarjen e një veprë të përfshirë në një pjesë konkrete. Shitja e parë në Komunitet e veprës fillestare ose kopjeve të saj nga mbajtësi i të drejtave ose me pranimin e tij e bën të pavlefshme të drejtën për të kontrolluar rishitjen e produktit në Komunitet. Kjo e drejtë nuk bëhet e pavlefshme përsa i përket veprës fillestare ose kopjeve të saj të shitura nga mbajtësi i të drejtave ose me pranimin e tij jashtë Komunitetit. Të drejtat e qiradhënies ose huadhënies për autorët përcaktohen në Direktivën 92/100/KEE. E drejta e shpërndarjes e parashikuar në këtë direktivë nuk cenon dispozitat në lidhje me të drejtat e qiradhënies dhe huadhënies shprehur në Kapitullin 1 të asaj direktive.

(29) Çështja e pavlefshmërisë nuk vlen në rastin e shërbimeve dhe shërbimeve në linjë në veçanti. Kjo zbatohet gjithashtu në lidhje me kopjen fizike të një veprë ose temë tjetër bërë nga përdoruesi i një shërbimi të tillë me pranimin e mbajtësit të të drejtave. Prandaj, e njëjta zbatohet për qiradhënien dhe huadhënien e veprës fillestare dhe kopjeve të saj ose tema të tjera të cilat janë shërbime nga natyra. Ndryshe nga CD-ROM ose CD-I, në të cilat raste pronësia intelektuale është e përfshirë në një mjet material, që do të thotë një artikull i përbërë prej produktesh, çdo shërbim në linjë është në të vërtetë një akt që duhet t'i nënshtrohet autorizimit nëse përcaktohet kështu nga e drejta e autorit ose të drejta të lidhura me të.

(30) Te drejtat e përmendura në këtë direktivë mund të transferohen, caktohen ose t'i nënshtrohen dhënies së licensave me kontratë, pa cenuar ligjin kombëtar përkatës për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

(31) Duhet të ruhet një baraspeshë e drejtë e të drejtave dhe interesave ndërmjet kategorive të ndryshme të mbajtësve të të drejtave, si dhe ndërmjet kategorive të ndryshme të mbajtësve të të drejtave dhe përdoruesve të temave të mbrojtura. Përrjashtimet dhe kufizimet ekzistuese të të drejtave siç përcaktohet nga Shtetet Anëtare duhet të rivlerësohen duke marrë parasysh mjedisin e ri elektronik. Dallimet ekzistuese të përjashtimeve dhe kufizimeve të disa akteve të ndaluara kanë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në funksionimin e tregut të brendshëm të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të. Dallime të tilla mund të bëhen më të theksuara duke marrë parasysh zhvillimin e mëtejshëm të shfrytëzimit tejkufitar të veprave dhe aktiviteteve ndërkuftare. Në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, përjashtime dhe kufizime të tilla duhet të përcaktohen në

mënyrë më të harmonizuar. Shkalla e harmonizimit të tyre duhet të bazohet në ndikimet e tyre në funksionimin e normal të tregut të brendshëm.

(32) Kjo direktivë parashikon një renditje të plotë përjashtimesh dhe kufizimesh të të drejtës së riprodhimit dhe të drejtës së komunikimit me publikun. Disa përjashtime ose kufizime zbatohen vetëm për të drejtën e riprodhimit, nëse është e përshtatshme. Rënditja merr parasysh traditat ligjore të ndryshme të Shteteve Anëtare, sikur se, në të njëjtën kohë, ka për qëllim të sigurojë funksionimin e tregut të brendshëm. Shtetet Anëtare duhet të arrijnë një zbatim logjik të këtyre përjashtimesh dhe kufizimesh, i cili do vlerësohet kur të kryhet rishikimi i zbatimi të ligjit në të ardhmen.

(33) E drejta ekskluzive e riprodhimit duhet t'i nënshtrohet një përjashtimi për të lejuar akte të caktuara riprodhimi të përkohshëm, të cilat janë riprodhime kalimtare ose dytësore, duke formuar një pjesë kryesore dhe thelbësore të një procesi teknologjik dhe që realizohen për arsyen e vetme të mundësisimit ose të transmetimit efikas në një rrjet ndërmjet palëve të treta nga një ndërmjetës, ose përdorimin e ligjshëm të një veprë ose teme tjetër për t'u krijuar. Aktet e riprodhimit në fjalë nuk duhet të kenë një vlerë ekonomike të ndarë në vetvete. Në një shkallë të tillë që ato të plotësojnë këto kushte, ky përjashtim duhet të përfshijë akte të cilat mundësojnë shqyrtimin si dhe akte magazinimi, duke përfshirë dhe ato që mundësojnë sistemet e transmetimit të funksionojnë me efikasitet, me kusht që ndërmjetësi nuk e ndryshon informacionin dhe nuk ndërhyr në përdorimin e ligjshëm të teknologjisë, e njohur dhe përdorur gjerësisht nga industria, për të mbledhur të dhëna për përdorimin e informacionit. Përdorimi duhet të gjykohej i ligjshëm nëse autorizohet nga mbajtësi i të drejtave ose është i pandaluar nga ligji.

(34) Shteteve Anëtare duhet t'u jepet mundësia e parashikimit të një sërë përjashtimesh ose kufizimesh për raste si qëllime formimi ose shkencore, në dobi të institucioneve publike si librari dhe arkiva, për qëllime raportimi lajmesh, për citime, për përdorimi nga njerëz me aftësi të kufizuara, për përdorime të sigurisë publike dhe për përdorime të veprimeve administrative dhe gjyqësore.

(35) Në raste të caktuara përjashtimesh dhe kufizimesh, mbajtësit e të drejtave duhet të marrin shpërblim të drejtë për përdorimin e veprave të tyre të mbrojtura ose temave të tjera. Kur përcaktohet forma, planet e hollësishme dhe niveli i mundshëm i një shpërblimi të drejtë të tillë duhet të merren parasysh rrethanat e veçanta në çdo rast. Kur vlerësohen këto rrethana, një kriter i vlefshëm është dëmi i mundshëm që i shkaktohet mbajtësit të të drejtave nga akti në fjalë. Në rastet kur mbajtësit e të drejtave kanë marrë tashmë pagesën e tyre në një mënyrë tjetër, për shembull, si pjesë e një tarife licensimi, nuk bëhet asnjë pagesë tjetër ose e veçantë. Niveli i shpërblimit duhet të marrë parasysh plotësisht shkallën e përdorimit të masave të mbrojtjes teknologjike të përmendura në këtë direktivë. Në raste të caktuara kur mbajtësi i të dhënave cenohet minimalisht, nuk ka asnjë detyrim për pagesë.

(36) Shtetet Anëtare mund të parashikojnë shpërblim të drejtë për mbajtësit e të drejtave gjithashtu kur zbatohen dispozitat jo të detyrueshme për përjashtimet dhe kufizimet, të cilat nuk kërkojnë shpërblim të tillë.

(37) Skemat kombëtare ekzistuese të riprografisë, nëse ekzistojnë, nuk përbëjnë pengesa të mëdha për tregun e brendshëm. Shtetet Anëtare duhet të lejohen që të parashikojnë një përjashtim ose kufizim në lidhje me riprografinë.

(38) Shtetet Anëtare duhet të lejohen të parashikojnë një përjashtim ose kufizim të të drejtës së riprodhimit për disa lloje riprodhimi materialesh audio, vizive dhe audiovizive për përdorim vetjak, të shoqëruar nga një shpërblim i drejtë. Ky veprim mund të përfshijë futjen ose vazhdimin e skemave të shpërblimit që barazojnë cenimin e mbajtësve të të drejtave. Edhe pse dallimet ndërmjet atyre skemash shpërblimi ndikojnë funksionimin e tregut të brendshëm, ato dallime, në lidhje me riprodhimin vetjak analog, nuk duhet të kenë një ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Kopjimi vetjak dixhital ka më shumë mundësi që të jetë më i përhapur dhe

të ketë një ndikim ekonomik më të madh. Prandaj, ndryshimet ndërmjet kopjimit vetjak analog dhe dixhital duhet të merren parasysh dhe një dallim duhet të bëhet ndërmjet tyre në raste të caktuara.

(39) Nëse zbatohet përjashtimi ose kufizimi për kopjimin vetjak, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh zhvillimet ekonomike dhe teknologjike, në veçanti në lidhje me kopjimin vetjak dixhital dhe skemave të shpërblimit, në ato raste kur janë të disponueshme masat e mbrojtjes teknologjike. Përjashtime ose kufizime të tilla nuk duhet të pengojnë përdorimin e masave teknologjike ose zbatimin e tyre kundër shmangieve.

(40) Shtetet Anëtare mund të parashikojnë një përjashtim ose kufizim në dobi të disa organizmave jofitimprurëse, si biblioteka të hapura për publikun dhe institucione të barasvlefshme, si dhe arkiva. Sidoqoftë, ky veprim duhet të kufizohet vetëm për raste të veçanta të cilat mbulohen nga e drejta e riprodhimit. Një përjashtim ose kufizim i tillë nuk duhet të mbulojë përdorime në kuptimin e dërgimit në linjë të veprave të mbrojtura ose temave të tjera. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë mundësinë e Shteteve Anëtare për të hequr dorë nga e drejta ekskluzive e huadhënies publike në përputhje me nenin 5 të Direktivës 92/100/KEE. Prandaj, duhet të nxiten kontrata ose licenca të veçanta të cilat, pa krijuar çekuilibër, mbështesin organizma të tilla dhe qëllimet shpërndarëse të cilat ato kanë.

(41) Nëse zbatohet përjashtimi ose kufizimi në lidhje me regjistrime të përkohshme të bëra nga organizata transmetuese, nënkuptohet që mjediset e vetë transmetuesit përfshijnë ato të një personi që vepron në emër të dhe nën përgjegjësinë e organizatës transmetuese.

(42) Nëse zbatohet përjashtimi ose kufizimi për qëllime formimi jotregtar dhe kërkimi shkencor, duke përfshirë dhe mësimin në distancë, natyra jotregtare e aktivitetit në fjalë duhet të përcaktohet nga vetë aktiviteti. Struktura organizuese dhe mjetet e financimit të organizmit në fjalë nuk përbëjnë faktorë vendimtarë në këtë kuptim.

(43) Në çdo rast është e rëndësishme për Shtetet Anëtare të miratojnë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar aksesin në vepra nga persona që vuajnë nga një kufizim aftësisht që përbën një pengesë në përdorimin e vetë veprave, duke i dhënë kujdes të veçantë mënyrave të aksesueshme.

(44) Nëse zbatohen përjashtimet dhe kufizimet e parashikuara në këtë direktivë, ato duhet të ushtrohen në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Përjashtime dhe kufizime të tilla nuk duhet të zbatohet në një mënyrë që cenon interesat e ligjërara të mbajtësit të të drejtave ose që bie në kundërshtim me shfrytëzimin normal të veprës së tij ose temave të tjera. Parashikimi i përjashtimeve ose kufizimeve të tilla nga Shtetet Anëtare duhet, në veçanti, të pasqyrojnë në mënyrën e duhur ndikimin ekonomik në rritje që përjashtime ose kufizime të tilla mund të kenë në kuptimin e mjedisit elektronik të ri. Prandaj, fusha e zbatimit e disa përjashtimeve ose kufizimeve duhet të kufizohet edhe me tepër për sa i përket disa përdorimesh të reja të veprave dhe temave të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit.

(45) Përjashtimet dhe kufizimet e përmendura në nenin 5 pikat 2, 3 dhe 4 nuk duhet, sidoqoftë, të ndalojnë përcaktimin e marrëdhënieve kontraktuese të planifikuara për të siguruar një shpërblim të drejtë për mbajtësit e të drejtave për aq sa lejohet nga ligji kombëtar.

(46) Përdorimi i ndërmjetësisë mund të ndihmojë përdoruesit dhe mbajtësit e të drejtave të zgjidhin mosmarrëveshjet. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare brenda Komitetit të Kontaktit, duhet të ndërmarrë një studim për të marrë parasysh rrugë ligjore të reja për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

(47) Zhvillimi teknologjik do t'i lejojë mbajtësit e të drejtave të shfrytëzojnë masa teknologjike të planifikuara për të ndaluar ose kufizuar akte të paautorizuara nga mbajtësit e të drejtave të çfarëdo të drejte autori, të drejtash të

lidhura me të drejtën e autorit ose të drejte *sui generis* në baza të të dhënave. Sidoqoftë, rreziku ekziston në faktin që mund të kryhen aktivitete të jashtëligjshme në mënyrë që të mundësojë ose të lehtësojë shmangien e mbrojtjes teknike të dhënë nga këto masa. Në mënyrë që të shmangen përjasje ligjore të paqëndrueshme që, me shumë mundësi, mund të pengojnë funksionimin e tregut të brendshëm, ka nevojë të parashikohet një mbrojtje ligjore e harmonizuar kundër shmangieve të masave teknologjike të efektshme dhe kundër përhapjes së pajisjeve dhe produkteve ose shërbimeve që kanë këtë qëllim.

(48) Një mbrojtje ligjore e tillë duhet të jepet në lidhje me masat teknologjike që kufizojnë akte të paautorizuara nga mbajtës të të drejtave të çfarëdo të drejte autori, të drejtash të lidhura me të drejtën e autorit ose të drejte *sui generis* në baza të të dhënave por, sidoqoftë, pa ndaluar funksionimin normal të pajisjeve elektronike dhe zhvillimin teknologjik të tij. Një mbrojtje ligjore e tillë nuk nënkupton një detyrim për të hartuar pajisje, produkte, pjesë ose shërbime të cilat i përputhen masave teknologjike, për sa kohë që një pajisje, produkt, pjesë ose shërbim i tillë nuk ndalohet sipas nenit 6. Një mbrojtje ligjore e tillë duhet të respektojë proporcionalitetin dhe nuk duhet të ndalojë ato pajisje ose aktivitete, të cilat kanë një qëllim të rëndësishëm nga ana tregtare ose një përdorim tjetër ndryshe nga shmangia e mbrojtjes teknike. Në veçanti, kjo mbrojtje nuk duhet të pengojë kërkimin shkencor në fushën e kriptografisë.

(49) Mbrojtja ligjore e masave teknologjike nuk cenon zbatimin e dispozitave kombëtare, të cilat mund të ndalojnë pronësinë vetjake të pajisjeve, produkteve ose pjesëve që shmangin masat teknologjike.

(50) Një mbrojtje ligjore e harmonizuar e tillë nuk ndikon dispozita të veçanta për mbrojtjen siç parashikohet në Direktivën 91/250/KEE. Në veçanti, nuk duhet të zbatohet për mbrojtjen e masave teknologjike që përdoret në lidhje me programet kompjuterike, që adresohet ekskluzivisht në atë direktivë. Kjo mbrojtje nuk duhet as të kufizojë as të ndalojë zhvillimin ose përdorimin e çfarëdo mjeti të shmangies së masave teknologjike që është i nevojshëm për mundësimin e ndërmarrjes së akteve në përputhje me kushtet e nenit 5 pika 3 ose nenit 6 të Direktivës 91/250/KEE. Nenet 5 dhe 6 të asaj direktive përcaktojnë ekskluzivisht përjashtimet e të drejtave ekskluzive të zbatueshme për programet kompjuterike.

(51) Mbrojtja ligjore e masave teknologjike zbatohet pa cenuar politikën publike, siç përmendet në nenin 5, ose sigurinë publike. Shtetet Anëtare duhet të nxitin masa vullnetare të marra nga mbajtësit e të drejtave, duke përfshirë përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërmjet mbajtësve të të drejtave dhe palëve të tjera të interesuara, për të lehtësuar arritjen e objektivave të disa përjashtimeve ose kufizimeve të parashikuara në ligjin kombëtar në përputhje me këtë direktivë. Në mungesë të masave vullnetare të tilla ose marrëveshjes brenda një kohe të arsyeshme, Shtetet Anëtare duhet të marrin masa të duhura për të siguruar që mbajtësit e të drejtave i njohin përfituesit me këto përjashtime ose kufizime bashkë me mjetet e duhura për të përfituar nga ato, duke ndryshuar një masë teknologjike të zbatuar ose me mjete të tjera. Sidoqoftë, në mënyrë që të ndalohen abuzimet me masa të tilla të marra nga mbajtësit e të drejtave, duke përfshirë dhe ato brenda kuadrit të marrëveshjeve, ose të marra nga një Shtet Anëtar, çdo masë teknologjike e përdorur në zbatimin e masave të tilla duhet të gëzojë mbrojtje ligjore.

(52) Nëse zbatohet një përjashtim ose kufizim për kopjim vetjak në përputhje me nenin 5 pika 2 germa (b), Shtetet Anëtare duhet, në të njëjtën mënyrë, të nxitin përdorimin e masave vullnetare për të lehtësuar arritjen e objektivave të përjashtimeve ose kufizimeve të tilla. Nëse, brenda një hapësire kohore të arsyeshme, nuk është marrë asnjë masë vullnetare për të mundësuar riprodhimin për përdorim vetjak, Shtetet Anëtare mund të marrin masa për t'i mundësuar përfituesve përdorimin e përjashtimit ose kufizimit përkatës për të përfituar nga ky. Masa vullnetare të marra nga mbajtësit e të drejtave, duke përfshirë marrëveshje ndërmjet mbajtësve të të dhënave dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe masa të marra nga Shtete Anëtare, nuk i ndalojnë mbajtësit e të drejtave të përdorin masa teknologjike të cilat përshtaten me përjashtimet dhe kufizimet për kopjimin vetjak në ligjin kombëtar në përputhje me nenin 5 pika 2 germa (b), duke marrë parasysh kushtin e shpërblimit të drejtë sipas asaj dispozite dhe dallimet e mundshme ndërmjet kushteve të ndryshme të përdorimit në përputhje me nenin 5 pika 5, si kontrolli

i numrit të riprodhimeve. Në mënyrë që të ndalohet abuzimi i këtyre masave, çdo masë teknologjike e përdorur në zbatimin e tyre duhet të gëzojë mbrojtje ligjore.

(53) Mbrojtja e masave teknologjike duhet të sigurojë një mjedis të sigurtë për dhënien e shërbimeve me kërkesë në linjë, në një mënyrë të tillë që publiku të ketë akses në vepra ose tema të tjera nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur nga ai vetë. Nëse shërbime të tilla rregullohen nga marrëveshje kontraktuese, nënparagrafit i parë dhe i dytë i nenit 6 pika 4 nuk zbatohen. Forma jondërvepruese të përdorimit në linjë duhet të vazhdojnë t'i nënshtrohen atyre dispozitave.

(54) Progres i rëndësishëm është bërë në standardizimin ndërkombëtar të sistemeve teknike të identifikimit të veprave dhe temave të mbrojtura të formatit dixhital. Në një mjedis me rrjetëzim në rritje, dallimet ndërmjet masave teknologjike mund të çojnë në një mospërputhje sistemesh brenda Komunitetit. Duhet nxitur përputhshmëria dhe ndërveprueshmëria e sistemeve të ndryshme. Është shumë e këshillueshme që të nxitet zhvillimi i sistemeve botërore.

(55) Zhvillimi teknologjik do të lehtësojë shpërndarjen e veprave, kryesisht në rrjete, dhe kjo do të krijojë nevojën që mbajtësit e të drejtave të identifikojnë më mirë veprat ose temat e tjera, autorin ose çdo mbajtës tjetër të të drejtave dhe të japin informacion për kushtet e përdorimit të veprës ose temave të tjera në mënyrë që të bëjë më të lehtë organizimin e të drejtave të lidhura me to. Mbajtësit e të drejtave duhet të nxitin të përdorin shenja që tregojnë, përveç informacionit të lartpërmendur, *inter alia*, autorizimin e tyre, kur t'i vendosin veprat ose temat e tjera në rrjete.

(56) Sidoqoftë, ekziston rreziku i aktiviteteve të jashtëligjshme me qëllim heqjen ose ndryshimin e informacionit elektronik që organizon të drejtën e autorit të lidhur me të, ose ndryshe shpërndarjen, importimin për shpërndarje, transmetimin, komunikimin për publikun ose bërjen të disponueshme për publikun të veprave ose temave të tjera të mbrojtura nga të cilat një informacion i tillë është zhvendosur pa autorizim. Në mënyrë që të shmangen përjasje ligjore të paqëndrueshme që, me shumë mundësi mund të pengojnë funksionimin e tregut të brendshëm, ka nevojë të parashikohet një mbrojtje ligjore e harmonizuar kundër çdo aktiviteti të tillë.

(57) Çdo sistem informacioni të organizimit të të drejtave të lartpërmendur mund, bazuar në projektimin e tyre, në të njëjtën kohë, të përpunojnë të dhëna personale për modelet e konsumit nga individë të temave të mbrojtura dhe të gjurmojnë sjelljen në linjë. Këto mjete teknike, në funksionet e tyre teknike, duhet të përfshijnë mbrojtje të fshtësisë në përputhje me Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 24 tetor 1995, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënash [10].

(58) Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë sanksione dhe masa korrigjuese të efektshme për shkeljet e të drejtave dhe të detyrimeve të përcaktuara në këtë direktivë. Ata duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme të sigurojnë që ato sanksione dhe masa korrigjuese të zbatohen. Masat e parashikuara duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe frenuese dhe duhet të përfshijnë mundësinë për të kërkuar zhdëmtim dhe/ose urdhër ndalues dhe, nëse është e përshtatshme, për të bërë kërkesë për konfiskim të materialit shkelës.

(59) Në mjedisin dixhital, në veçanti, shërbimet e ndërmjetësve mund të përdoren gjithnjë e më shumë nga palë të treta për aktivitete shkelëse. Në shume raste ndërmjetës të tillë janë në pozicionin më të përshtatshëm për t'i dhënë fund aktiviteteve shkelëse të këtij lloji. Prandaj, pa cenuar sanksione dhe masa korrigjuese të tjera të disponueshme, mbajtësit e të drejtave duhet të gëzojnë të drejtën për të bërë kërkesë për urdhër gjykatë kundër një ndërmjetësi që është përgjegjës për mbajtjen e një shkeljeje të një pale të tretë të një veprë të mbrojtur ose teme tjetër në një rrjet. Kjo mundësi duhet të jetë e disponueshme edhe kur aktet e kryera nga një ndërmjetës janë përjashtime sipas nenit 5. Kushtet dhe mënyrat e lidhura me urdhra ndalues të tillë lihet si kompetencë e ligjit kombëtar të Shteteve Anëtare.

(60) Mbrojtja e dhënë sipas kësaj direktive nuk duhet të cenojë dispozitat ligjore kombëtare ose Komunitare në fusha të tjera, si pronësia intelektuale, mbrojtja e të dhënave, aksesit me kusht, aksesit në dokumente publike dhe rregulli i kronologjisë së shfrytëzimit të media-s që mund të ndikojë mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.

(61) Në mënyrë që të jetë në përputhje me Traktatin e OBPI-së për Shfaqjet dhe Fonogramet, Direktivat 92/100/KEE dhe 93/98/KEE duhet të ndryshohen,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË :

KAPITULLI I OBJEKTIVI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë i kushtohet mbrojtjes ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, në kuadrin e tregut të brendshëm, me vëmendje të veçantë mbi shoqërinë e informacionit.
2. Me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 11, kjo direktivë nuk prek dhe nuk cenon në asnjë mënyrë dispozitat ekzistuese Komunitare në lidhje me:
 - (a) mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike;
 - (b) të drejtën e dhënies me qira, të drejtën e huazimit dhe disa të drejta në lidhje me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale;
 - (c) të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, të zbatueshme mbi transmetimin e programeve nëpërmjet satelitit dhe ritransmetimit kabllor;
 - (d) afatin e mbrojtjes e të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura me të;
 - (e) mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave.

KAPITULLI II TË DREJTA DHE PËRJASHTIME

Neni 2

E drejta e riprodhimit

Shtetet Anëtare sigurojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose penguar riprodhimin me çfarëdo mjeti e në çdo formë, të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, të përkohshme ose të përhershme, , i të tërës ose i një pjese:

- (a) për autorët, e veprave të tyre;
- (b) për interpretuesit, e montimeve të interpretimeve të tyre;
- (c) për prodhuesit e fonogrameve, të fonogrameve të tyre;
- (d) për prodhuesit e montimeve të para të filmave, përsa i përket origjinalit dhe kopjeve të filmave të tyre;
- (e) për organizatat transmetuese, të montimeve të transmetimeve të tyre, qofshin këto të transmetuara nëpërmjet ajrit apo fijeve, përfshirë edhe ato me satelit apo kabëll.

Neni 3

E drejta e komunikimit publik të veprave dhe e drejta e vënies në dispozicion të publikut të përmbajtjeve të tjera

1. Shtetet Anëtare i sigurojnë autorëve të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose penguar çfarëdo komunikimi publik të veprave të tyre, me mjete me ose pa fije, përfshirë edhe vënien në dispozicion të publikut të veprave të tyre në një mënyrë të tillë , që të jenë të arritshme nga anëtarët e publikut në një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.
2. Shtetet Anëtare sigurojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose penguar vënien në dispozicion të publikut me mjete me ose pa fije, në një mënyrë të tillë , që të jenë të arritshme nga anëtarët e publikut në një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre:
 - (a) për interpretuesit, të montimeve të interpretimeve të tyre;
 - (b) për prodhuesit e fonogrameve, të fonogrameve të tyre;
 - (c) për prodhuesit e montimeve të para të filmave, të origjinalit dhe të kopjeve të filmave të tyre;
 - (d) për organizatat transmetuese, të montimeve të transmetimeve të tyre, qofshin këto transmetime të transmetuara nëpërmjet ajrit apo fijeve, përfshirë edhe ato me satelit apo kabëll.
3. Të drejtat që përmenden në paragrafin 1 dhe 2 nuk shterojnë nga asnjë akt i komunikimit publik ose i vënies në dispozicion të publikut sikurse është përcaktuar në këtë nen.

Neni 4

E drejta e shpërndarjes

1. Shtetet Anëtare i sigurojnë autorëve, përsa i përket origjinalit të veprave ose kopjeve të tyre, të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose penguar çfarëdo formë të shpërndarjes për publikun ,nëpërmjet shitjes apo mënyrave të tjera.
2. E drejta e shpërndarjes nuk shteron brenda Komunitetit përsa i përket origjinalit ose kopjeve të veprës, me përjashtim të rasteve kur shitja e parë ose një transferim tjetër i pronësisë në Komunitet të atij objekti, është bërë nga mbajtësi i të drejtës së autorit ose me miratimin e tij.

Neni 5

Përjashtime dhe kufizime

1. Aktet e përkohshme të riprodhimit sikurse përmenden në paragrafin 2, të cilat janë të rastësishme apo aksidentale dhe janë një pjesë thelbësore, dhe tërësore e një procesi teknologjik,qëllimi i vetëm i të cilit është:
 - (a) transmetimi në një rrjet ndërmjet palëve të treta përmes një ndërmjetësi ose;
 - (b) një përdorimi të ligjshëm të një vepre apo të një përmbajtjeje tjetër që priten të krijohen dhe që nuk kanë domethënien ekonomike të pavarur, përjashtohen nga e drejta e riprodhimit, të përcaktuar në nenit 2.
2. Shtetet Anëtare mund të sigurojnë përjashtime apo kufizime të së drejtës së riprodhimit, të përcaktuar në nenin 2 si në rastet e mëposhtme:
 - (a) përsa i përket riprodhimeve në letër apo në një mjedis të ngjashëm të kryer përmes përdorimit të çfarëdo lloj teknike fotografike ,apo përmes ndonjë procesi tjetër që ka rezultate të ngjashme, me përjashtim të partiturave muzikore, me kusht që mbajtësit e të drejtave, të marrin një kompensim të përshtatshëm;
 - (b) përsa i përket riprodhimit në çfarëdo mjedisi të bërë nga një person fizik për përdorime private dhe për synime që nuk janë direkt ose indirekt tregtare, me kusht që mbajtësit e të drejtave të marrin një

kompensim të përshtatshëm, i cili merr parasysh përdorimin ose mospërdorimin e masave teknologjike të përmendura në nenin 6 në veprën apo përmbajtjen përkatëse;

- (c) përsa i përket veprimeve specifike të riprodhimit të bëra nga biblioteka të hapura për publikun, institucione arsimore ose muze, apo nga arkiva të cilat nuk përdoren për interesa të drejtpërdrejta ose të tërthorta ekonomike a tregtare;
- (d) përsa i përket regjistrimeve kalimtare të veprave të bëra nga organizatat transmetuese përmes instrumenteve dhe transmetimeve të tyre, ruajtja e këtyre regjistrimeve në arkiva zyrtare mund të lejohet bazuar në karakterin e tyre të veçantë dokumentar;
- (e) përsa i përket riprodhimeve të transmetimeve të bëra nga institucione sociale në vijim të qëllimeve jo tregtare, si për shembull spitalet ose burgjet, me kusht që mbajtësit e të drejtave të marrin një kompensim të përshtatshëm.

3. Shtetet Anëtare mund të sigurojnë përjashtime ose kufizime të së drejtave ,që përcaktohen në paragrafët 2 e 3 si në rastet e mëposhtme:

- (a) përdorimi për qëllimin e vetëm të ilustrimit për mësimdhënie ose kërkime shkencore, përsa kohë që tregohet burimi, përfshirë edhe emrin e autorit, përveç se nëse kjo është e pamundur dhe në masë që justifikohet për arritjen e qëllimit jo tregtar;
- (b) përdorimet për përfitime të njerëzve me paaftësi, që lidhen drejtpërsëdrejti me paaftësinë dhe janë të një natyre jo tregtare në masën e nevojshme për paaftësinë specifike;
- (c) riprodhimi nga ana e shtypit komunikimi publik ose vënia në dispozicion e artikujve të botuar mbi tematikën aktuale ekonomike, politike ose fetare ,apo e veprave të transmetuara ose përmbajtjeve të tjera të të njëjtit karakter në rastet kur ky lloj përdorimi nuk është shprehimisht i rezervuar dhe përsa kohë që tregohet burimi përfshirë edhe emrin e autorit apo përdorimi i veprave ose i përmbajtjeve të tjera që lidhen me njoftimin e ngjarjeve aktuale, në masën e justifikuar nga qëllimi informues për sa kohë që tregohet burimi, përfshire edhe emrin e autorit, përveç se nëse kjo është e pamundur;
- (d) përdorimi i citimeve për qëllime, si për shembull kritika ose përmbledhje, me kusht që këto të lidhen me një vepër ose përmbajtje tjetër që është vënë ligjërisht në dispozicion të publikut paraprakisht, në të cilën tregohet burimi përfshirë edhe emri i autorit, përveç se nëse kjo është e pamundur dhe kur, përdorimi i tyre është në përputhje me praktikën e ndershme dhe në masën e nevojshme për qëllimin specifik;
- (e) përdorimi për qëllimin e sigurisë publike ose për të siguruar kryerjen, ose raportimin e duhur të procedurave administrative parlamentare apo gjyqësore;
- (f) përdorimi i fjalimeve politike si dhe i përmbledhjeve të leksioneve apo i veprave publike ose i përmbajtjeve të ngjashme, në masën e justifikuar për qëllimin informues dhe, me kusht që të tregohet burimi, duke përfshirë edhe emrin e autorit përveç rasteve nëse kjo është e pamundur;
- (g) përdorimi gjatë festimeve fetare ose festimeve zyrtare të organizuara nga një autoritet publik;
- (h) përdorimi i veprave si për shembull; vepra të arkitekturës ose skulpturës të bëra për t'u vendosur në mënyrë të përhershme në vende publike ;
- (i) përfshirja aksidentale e një vepre ose përmbajtjeje tjetër në materiale të tjera;
- (j) përdorimi për qëllim reklame të ekspozitave publike ose shitjeve të veprave artistike, në masën e nevojshme për promovimin e ngjarjes, përfshirë edhe çdo përdorim tjetër tregtar;
- (k) përdorimi për qëllim realizimi të karikaturës, parodisë ose imitimit;
- (l) përdorimi në lidhje me demonstrimin ose riparimin e pajisjeve;
- (m) përdorimi i një vepre artistike në formën e një ndërtese ose një vizatimi , plani apo dhe , i një ndërtese për qëllimet e rikonstruksionit të ndërtesës;
- (n) përdorimi përmes komunikimit ose vënies në dispozicion të anëtarëve individualë të publikut, për qëllim kërkimi ose studimi privat, nëpërmjet terminaleve të dedikuara brenda hapësirës së institucioneve, të përmendura në paragrafin 2 pika (c), të veprave dhe përmbajtjeve të tjera që nuk janë subjekt i afateve të blerjes ose licencimit që mbajnë koleksionet e tyre;

- (o) përdorimi në disa raste të tjera të një rëndësie të vogël, kur përjashtimet ose kufizimet tanimë ekzistojnë nën legjislacionin kombëtar me kusht që ato të lidhen me përdorime analoge dhe të mos ndikojnë qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve brenda Komunitetit, pa dëmtuar përjashtimet dhe kufizimet e tjera që përmban ky nen.
4. Kur Shtetet Anëtare mund të sigurojnë një përjashtim ose kufizim të së drejtës së riprodhimit në vijim të paragrafëve 2 dhe 3, ata mund të sigurojnë në mënyrë të ngjashme një përjashtim ose kufizim të së drejtës së shpërndarjes siç përmendet në nenin 4 në masën e justifikuar nga qëllimi i aktit të autorizuar të riprodhimit.
5. Përjashtimet dhe kufizimet e përmendura në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 zbatohen vetëm në disa raste të veçanta të cilat nuk bien ndesh me shfrytëzimin normal të veprës ose përmbajtjes tjetër dhe nuk dëmtojnë së tepërmi interesat e ligjshme të mbajtësit të së drejtave.

KAPITULLI III MBROJTJA E MASAVE TEKNOLOGJIKE DHE INFORMACIONEVE TË ADMINISTRIMIT TË TË DREJTAVE

Neni 6

Detyrime përsa i përket masave teknologjike

1. Shtetet Anëtare sigurojnë mbrojtje të përshtatshme ligjore kundër shmangies nga çdo masë teknologjike efektive që personi i përfshirë kryen me dijeni ose me kushte të arsyeshme, për të ditur që ai ose ajo po ndjek atë objektiv.
2. Shtetet Anëtare sigurojnë mbrojtje të përshtatshme ligjore kundër fabrikimit, importimit, shpërndarjes, shitjes, dhënies me qira, reklamimit për shitje ose dhënie me qira; apo zotërimit për qëllime tregtare të pajisjeve, produkteve ose pjesëve apo ofrimit të shërbimeve që :
- (a) promovohen, reklamohen ose tregtohen për qëllim të shmangies apo,;
 - (b) kanë vetëm qëllim ose përdorim të kufizuar me natyrë tregtare përveç se të shmangin apo;
 - (c) janë projektuar, prodhuar, përshtatur ose ekzekutuar kryesisht për të mundësuar, ose lehtësuar shmangien nga çdo masë efektive teknologjike.
3. Për qëllimet e kësaj direktive, shprehja ‘masa teknologjike’ nënkupton çdo teknologji, pajisje ose komponent që është shpikur për të parandaluar ose penguar gjatë operimit normal të tij, aktet e paautorizuara nga mbajtësi i çdo të drejte të autorit ose të drejtave të lidhura me të, mbi veprat ose përmbajtjet e tjera sikurse përcaktohet nga ligji, ose e drejta *sui generis* e përcaktuar në Kapitullin III të Direktivës 96/9/KE. Masat teknologjike konsiderohen ‘efektive’ kur përdorimi i një vepre të mbrojtur ose i një përmbajtjeje tjetër kontrollohet nga mbajtësit e të drejtave përmes përdorimit të një procesi mbrojtës ose kontrollues, si për shembull: kodim, çrradhitje ose transformim tjetër i veprës ose i përmbajtjeve të tjera, apo i një mekanizmi për kontrollin e kopjimit i cili arrin objektivin e mbrojtjes.
4. Pavarësisht nga mbrojtja ligjore e përcaktuar në paragrafin 1, në mungesë të masave vullnetare të marra nga ana e mbajtësve të të drejtave përfshirë marrëveshjet midis mbajtësve të të drejtave dhe palëve të tjera të interesuara, Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për të siguruar që mbajtësit e të drejtave vënë në dispozicion të përfituesve të një përjashtimi ose kufizimi sipas përcaktimit të legjislacionin kombëtar në përputhje me nenin 5 pika 2 germat (a), (c), (d), (e), pika 3 germat (a),(b) ose (e) mjetet e përfitimit nga ato përjashtime ose kufizime, në masën e nevojshme për të përfituar nga ai përjashtim ose kufizim dhe kur ai përfitues ka mundësi ligjore përdorimi të veprës së mbrojtur ose përmbajtjes përkatëse.

Një Shtet Anëtar mund gjithashtu, të marrë masa të tilla përsa i përket një përfituesi nga një përjashtim ose kufizim në përputhje me nenin 5 pika 2 germa (b), përveç se kur riprodhimi për përdorim privat është mundësuar tanimë nga ana e mbajtësve të të drejtave në masën e nevojshme për të përfituar nga përjashtimi ose kufizimi përkatës dhe në përputhje me parashikimin e nenit 5 pika 2 germa (b) dhe pika 5, pa penguar mbajtësit e të drejtave nga marrja e masave të përshtatshme lidhur me numrin e riprodhimeve në përputhje me këto dispozita. Masat teknologjike të përdorura vullnetarisht nga ana e mbajtësve të të drejtave, përfshirë ato të përdorura në zbatim të marrëveshjeve vullnetare dhe masat teknologjike të përdorura në zbatim të masave të marra nga ana e Shteteve Anëtare, gëzojnë mbrojtjen ligjore të përcaktuar në paragrafin 1.

Dispozitat e pikës së parë dhe të dytë, nuk zbatohen mbi veprat ose përmbajtjet e tjera të vëna në dispozicion të publikut në zbatim të termave kontraktuese të rëna dakord, në një mënyrë të tillë, që anëtarët e publikut mund t'i përdorin ato nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur nga vetë ata. Kur ky nen të zbatohet në kontekstin e Direktivës 92/100/KEE dhe 96/9/KE, ky paragraf të zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 7

Detyrime lidhur me informacionet e administrimit të të drejtave

1. Shtetet Anëtare sigurojnë mbrojtjen e përshtatshme ligjore kundër çdo personi që kryen me dashje dhe pa autorizim cilindo nga aktet e mëposhtme:
 - (a) heqjen ose tjetërsimin e çdo informacioni elektronik të administrimit të të drejtave;
 - (b) shpërndarjen, importimin për shpërndarje, transmetimin, komunikimin publik ose vënien në dispozicion të publikut të veprave apo përmbajtjeve të tjera të mbrojtura nga kjo direktivë ose nga Kapitulli III i Direktivës 96/9/KE, nga të cilat janë hequr ose tjetërsuar pa autorizim informacionet elektronike të administrimit të të drejtave, nëse ky person di, ose ka kushte të arsyeshme për të ditur, që me veprimin e tij po nxit, mundëson, lehtëson ose fsheh një shkelje të të drejtës së autorit ose të drejtave të lidhura me to, në përputhje me ligjin ose të drejtën *sui generis* në përputhje me Kapitullin III të Direktivës 96/9/KE.
2. Për qëllimet e kësaj direktive, shprehja 'informacion i administrimit të të drejtave' nënkupton çdo informacion i vendosur nga ana e mbajtësit të të drejtave që identifikon veprën ose përmbajtje tjetër të përmendur nga kjo direktivë ose të përfshirë nga e drejta *sui generis* e përcaktuar në Kapitullin III të Direktivës 96/9/KE, autorin ose çdo mbajtës tjetër të të drejtave ose çdo informacion mbi kushtet dhe afatet e përdorimit të veprës ose përmbajtjes tjetër dhe çdo numër ose kod që përfaqëson një informacion të tillë.

Pika e parë gjen zbatim kur, cilido nga këto lloje informacionesh është i shoqëruar me një kopje ose shfaqet i lidhur me komunikimin publik të një vepre, ose përmbajtjeje tjetër të përmendur nga kjo direktivë, ose të përfshirë nga e drejta *sui generis* e përcaktuar në Kapitullin III të Direktivës 96/9/KE.

KAPITULLI IV DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 8

Sanksione dhe masa korigjuese

1. Shtetet Anëtare parashikojnë sanksione dhe masa korigjuese të përshtatshme përsa i përket shkeljeve të të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë direktivë dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se këto sanksione dhe masa korigjuese janë zbatuar. Sanksionet duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe frenuese.

2. Secili Shtet Anëtar merr masat e nevojshme për të siguruar që mbajtësit e të drejtave, interesat e të cilëve preken nga një veprim i paligjshëm i kryer në territorin e tij të mund të nisë një proces për dëme dhe/ose një proces gjyqësor dhe, kur është e përshtatshme, për konfiskimin e materialeve në shkelje si edhe të pajisjeve, produkteve ose pjesëve për riformulim të përmendura në nenin 6 pika 2.
3. Shtetet Anëtare sigurojnë që mbajtësit e të drejtave të jenë në gjendje të nisnin një proces gjyqësor kundër ndërmjetësve, shërbimet e të cilëve përdoren nga të tretët për të shkelur një të drejtë autori ose një të drejtë të lidhur me të.

Neni 9

Vazhdueshmëria e zbatimit të dispozitave të tjera ligjore

Kjo direktivë nuk cenon dispozitat në lidhje veçanërisht me të drejtat e patentës, markave tregtare, të projektiveve, modeleve të veglave, topografive të produkteve gjysmëpërcjellëse, modelët e shkronjave, aksesin e kushtëzuar, aksesin në kabëll të shërbimeve transmetuese, mbrojtjen e thesareve kombëtare, kërkesat për depozitat e ligjshme, ligjet mbi praktikën e kufizuara dhe konkurrencën e pandershme, sekretet tregtare, sigurinë, konfidencialitetin, fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave, aksesin tek dokumentet publike, dhe ligjin e kontratës.

Neni 10

Zbatimi përgjatë kohës

1. Dispozitat e kësaj direktive zbatohen lidhur me të gjitha veprat dhe përmbajtjeve të tjera të përmendura në këtë direktivë që janë, më 22 dhjetor 2002, të mbrojtura nga legjislacioni i Shteteve Anëtare në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, ose që përmbushin kriteret për mbrojtje në përputhje me dispozitat e kësaj direktive ose dispozitat e përmendura në nenin 1 pika 2.
2. Kjo direktivë zbatohet pa cenuar asnjë akt të përfunduar dhe të drejta të fituara përpara 22 dhjetorit 2002.

Neni 11

Përshtatja teknike

1. Direktiva 92/100/KEE për rrjedhojë ndryshohet si më poshtë vijon:
 - (a) Neni 7 anulohet;
 - (b) Neni 10 pika 3 zëvendësohet si më poshtë: “3. Kufizimet zbatohen vetëm në disa raste të veçanta që nuk bien ndesh me shfrytëzimin normal të përmbajtjes dhe nuk dëmtojnë së tepërmi interesat e ligjshme të mbajtësit të të drejtave.”
2. Neni 3 pika 2 e Direktivës 93/98/KEE zëvendësohet si më poshtë: “2. Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve shuhen 50 vjet pas bërjes së montimit. Megjithatë, nëse fonogrami është botuar ligjërisht brenda kësaj periudhe, të drejtat e lartpërmendura shuhen 50 vjet pas datës së botimit të parë të ligjshëm. Nëse nuk është bërë asnjë botim i ligjshëm gjatë periudhës së përmendur në fjalinë e parë dhe nëse fonogrami i është komunikuar ligjërisht publikut brenda kësaj periudhe, të drejtat e përmendura shuhen 50 vjet pas datës së komunikimit të parë të ligjshëm publikut. Megjithatë, kur gjatë skadimit të periudhës së mbrojtjes së ofruar në vijim të këtij paragrafi në versionin e tij përpara ndryshimit me Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit e 22 majit 2001 mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to, në

shoqërinë e informacionit [11], të drejtat e prodhuesve të fonogrameve nuk mbrohen më 22 dhjetor 2002, ky paragraf nuk ka efekt për mbrojtjen përsëri të atyre të drejtave.”

Neni 12

Dispozita përfundimtare

1. Jo më vonë se, 22 dhjetor 2004 dhe pas kësaj çdo tre vjet, Komisioni i paraqet Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komitetit Ekonomik dhe Social një raport mbi zbatimin e kësaj direktive në të cilën *inter alia*, mbi bazën e informacioneve specifike të dhëna nga Shtetet Anëtare, ekzaminohet në veçanti zbatimin e neneve 5, 6 dhe 8 në frymën e zhvillimeve të tregut digjital. Në rastin e nenit 6, ekzaminohet në veçanti nëse ai nen siguron një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje dhe nëse aktet e lejuara nga ligji janë ndikuar negativisht nga përdorimi i masave efektive teknologjike. Kur është e nevojshme, veçanërisht për të siguruar funksionimin e tregut të brendshëm në vijim të nenit 14 të Traktatit, ai paraqet propozime për ndryshime të kësaj direktive.
2. Mbrojtja e të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit me këtë direktivë nuk prek dhe nuk ndikon në mbrojtjen e të drejtave të autorit.
3. Krijohet për rrjedhojë një komitet kontakti. Ai përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare. Ai kryesohet nga një përfaqësues i Komisionit dhe mblidhet ose me iniciativë të kryetarit ose me kërkesë të delegacionit të një Shteti Anëtar.
4. Detyrat e komitetit janë si më poshtë:
 - (a) të ekzaminojë pasojat e kësaj direktive mbi funksionimin e tregut të brendshëm, dhe të nxjerrë në pah ndonjë vështirësi;
 - (b) të organizojë konsultime mbi të gjitha paqartësitë që dalin nga zbatimi i kësaj direktive;
 - (c) të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimet përkatëse të legjislacionit dhe të kazuseve, si dhe ato ekonomike, sociale, kulturore e teknologjike;
 - (d) të veprojë si një forum për vlerësimin e tregut digjital tek veprat dhe elementet e tjera, përfshirë edhe kopjimin privat dhe përdorimin e masave teknologjike.

Neni 13

Zbatimi

1. Shtetet Anëtare i japin fuqi ligjore ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të nevojshme në zbatim të kësaj direktive përpara 22 dhjetorit 2002. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për to. Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, dato duhet të përmbajnë një referencë për këtë direktivë, ose shoqërohen me një referencë të tillë që të bëhet botimi zyrtar i tyre. Metoda e bërjes së një reference të tillë përcaktohet nga Shtetet Anëtare.
2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave të legjislacionit të brendshëm që do miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 15

Të adresuarit

Kjo direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 22 maj 2001.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

N.Fontaine

Për Këshillin

Presidenti

M. Winberg

[1] GZ C 108, 07.04.1998, fq. 6 dhe GZ C 180, 25.06.1999, fq. 6.

[2] GZ C 407, 28.12.1998, fq. 30.

[3] Opinioni i Parlamentit Europian, datë 10 shkurt 1999 (GZ C 150, 28.05.1999, fq. 171), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 28 shtator 2000 (GZ C 344, 01.12.2000, fq. 1) dhe Vendimi i Parlamentit Europian, datë 14 shkurt 2001 (i pabotuar ende në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Këshillit, datë 9 prill 2001.

[4] GZ L 178, 17.07.2000, fq. 1.

[5] Direktiva e Këshillit 91/250/KEE, datë 14 maj 1991, për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike (GZ L 122, 17.05.1991, fq. 42). Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 93/98/KEE.

[6] Direktiva e Këshillit 92/100/KEE, datë 19 nëntor 1992, për të drejtën e qiradhënies dhe huadhënies dhe disa të drejta të lidhura me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale (GZ L 346, 27.11.1992, fq. 61). Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 93/98/KEE.

[7] Direktiva e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, për bashkërendimin e disa rregullave në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të të zbatueshme për transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllore (GZ L 248, 06.10.1993, fq. 15).

[8] Direktiva e Këshillit 93/98/KEE, datë 29 tetor 1993, që harmonizon afatin e mbrojtjes të të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura me të (GZ L 290, 24.11.1993, fq. 9).

[9] Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 11 mars 1996, për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave (GZ L 77, 27.03.1996, fq. 20).

[10] GZ L 281, 23.11.1995, fq. 31.

[11] GZ L 167, 22.06.2001, fq. 10.